

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Mbi raportin e monitorimit të

MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRISË

për tremujorin e tretë të vitit 2014

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas katër programeve buxhetore të miratuara, e më specifikisht:

1. *Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”*
2. *Mbeshtetje për Energjinë*
3. *Mbeshtetje për Burimet Natyrore*
4. *Mbeshtetje për mbikqyrjen e standarteve teknike të hidrokarbureve dhe minierave*

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë mbi monitorimin e buxhetit për periudhën 9-mujore të vitit, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë institucion, paraqitet si më poshtë vijon.

	Emërtimi	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	928,978	511,733	65.8%	75.8%	55.1%
1.1	<i>Personeli</i>	429,186	298,831	30.4%	44.3%	69.6%
1.2	<i>Operative</i>	499,792	212,902	35.4%	31.5%	42.6%
2	Shpenzime kapitale	482,000	158,889	34.2%	23.5%	33.0%
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	291,000	84,332	20.6%	12.5%	29.0%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	191,000	74,557	13.5%	11.0%	39.0%
3	TOTALI	1,410,978	670,622	100.0%	99.3%	47.5%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet edhe nga tabela e mësipërme, shpenzimet korente përbëjnë rreth 66% të fondeve të planifikuara për 2014 për MEI, dhe rreth 76% të shpenzimeve faktike të periudhës 9-mujore. Shpenzimet korente paraqesin një realizim prej 55% në raport me planin vjetor. Shpenzimet për personelin, rezultojnë në rreth 70% të planit, ndërkohë që shpenzimet operative rezultojnë në 42.6% të planit vjetor. Niveli i investimeve, i planifikuar për vitin 2014, përbën rreth 1/3 e fondeve të institucionit, dhe për tremujorin e tretë të vitit ato paraqesin një nivel realizimi prej vetëm 33%. Kjo tregon një vazhdim të ngadalësisë në ecurinë e realizimit të investimeve publike.

Për periudhën 9-mujore, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, për secilin program, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			TOTALI I SHPENZIMEVE		% e realizimit
	PLAN	FAKT	Realizimi	PLAN	FAKT	Realizimi	Plan	Fakt	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	501,230	230,691	46.0	306,600	90,172	29.4	807,830	320,863	39.7
Mbështetje për Energji	12,000	6,109	50.9	1,000	440	44.0	13,000	6,549	50.4
Mbështetje për Burimet Natyrore	164,647	113,319	68.8	78,000	56,989	73.1	242,647	170,308	70.2
Mbështetje për Mbikqyrjen e Standarteve të Hidrokarbureve dhe Minierave	251,102	161,614	64.4	96,400	11,288	11.7	347,502	172,902	49.8
TOTALI	928,978	511,733	55.1	482,000	158,889	33.0	1,410,978	670,622	47.5

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Për të katërt programet e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, përqindja e realizimit të shpenzimeve, varion nga 40% për programin e aparatit të MEI, deri në 70% për programin “Mbështetje për Burimet Natyrore”, gjë që ka çuar në një realizim prej 47.5 % në rang institucioni.

Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime 2014 dhe realizimit të tremujorit të tretë të vitit 2014, paraqitet si më poshtë:

Kodi	Emërtimi i Programit	Struktura e Buxhetit 2014		
		Plani Fillestar	Plani me ndryshime	Fakti
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	54.5	57.3	47.8
04320	Mbështetje për Energjinë	1.0	0.9	1.0
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	19.7	17.2	25.4
04440	Mbështetje për mbikqyrjen e standarteve teknike të hidrokarbureve dhe minierave	24.8	24.6	25.8
	TOTALI	100.00%	100.00%	100.00%

Burimi: Ministria e Financave

Në terma vjetorë, programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, zë rreth 55% të fondeve totale të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në fillim të vitit 2014. Ndërkohë, referuar shpenzimeve faktike të 9-mujorit, evidentohet se shpenzimet për aparatit të MEI-t rezultojnë të jenë 47.8% e shpenzimeve të periudhës. Gjithashtu, duhet të theksohet se pjesa tjetër e fondeve të miratuara për këtë ministri, shpërndahen në tre programet buxhetore sipas rradhës së mëposhtme. Rreth 25% e totalit të shpenzimeve faktike, janë përdorur në programin buxhetor “Mbështetje për Burimet Natyrore”, 26% në “Mbështetje për mbikqyrjen e standarteve teknike të hidrokarbureve dhe minierave”, dhe në fund vetëm 1% në programin “Mbështetje për Energjinë”.

MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE DHE PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi “Planifikimi, menaxhimi, administrimi”

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 50 përqind të totalit të shpenzimeve 9-mujore, ndërkohë që në terma vjetore, ky program përmbledh rreth 58% të fondeve të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Sipas zërave kryesorë të klasifikimit ekonomik, krahasuar me planin vjetor, dhe faktin e periudhës, realizimi paraqitet si më poshtë.

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	501,230	230,691	62.0%	71.9%	46.0%
1.1	Personeli	130,186	86,940	16.1%	27.1%	66.8%
1.2	Operative	371,044	143,751	45.9%	44.8%	38.7%
2	Shpenzime kapitale	306,600	90,172	38.0%	28.1%	29.4%
2.1	Financim i brendshëm	115,600	15,615	14.3%	4.9%	13.5%
2.2	Financim i huaj	191,000	74,557	23.6%	23.2%	39.0%
3	TOTALI	807,830	320,863	100.0%	100.0%	39.7%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse mund të konstatohet nga tabela e mësipërme, shpenzimet korente prej 501.2 milion lek, përbëjnë 62% të fondeve totale të planifikuara për vitin 2014, paraqesin një nivel realizimi prej vetëm 46%. Brenda tyre, shpenzimet për personelin, të parashikuara në 130 milion lek, përbëjnë vetëm 16% të fondeve të planifikuara për institucionin, paraqesin një nivel realizimi në rreth 67% të planit vjetor, ndërkohë që edhe shpenzimet operative shfaqin një nivel realizimi mjaft të ulët prej vetëm 38.7%.

Shpenzimet kapitale, prej 306.6 milion lek, përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxhetit të MEI, për vitin 2014. Gjithashtu, në përbërjen e investimeve vihet re prevalenca absolute e projekteve me financim të huaj, prej 191 milion lek në vit. Më konkretisht, shpenzimet kapitale përbëjnë 38% të buxhetit vjetor të miratuar për MEI-n, dhe 28% të shpenzimeve faktike të periudhës. Investimet janë realizuar në vetëm 29.4% të fondit vjetor, ose në rreth 90 milion lek, në periudhën 9-mujore. Një arsye për këtë nivel të ulët realizimi është fakti se procesi i prokurimit kërkon plotësimin e afateve ligjore, të cilat në mjaft raste mund të kërkojnë një periudhë të gjatë kohe. Në këtë program janë parashikuar 12 produkte buxhetore, të cilat, për periudhën 9-mujore vetëm një është realizuar plotësisht, ndërkohë që të tjerët janë realizuar pjesërisht. Në fakt, krahasimi duhet t'i referohet edhe planit të periudhës jo vetëm planit vjetor.

Programi “Mbështetje për Energjinë”

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 1 përqind të totalit të shpenzimeve faktike 9-mujore. Sipas zërave kryesor krahasuar me zërat e planin vjetor realizimi paraqitet si më poshtë:

Ky program përmbledh vetëm 1 % të fondeve vjetore të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Në total, programi rezulton me një realizim të shpenzimeve prej rreth 50%, ndërkohë që shpenzimet për personelin, si zëri kryesor i shpenzimeve për programin, shfaqin nivelin realizimit prej rreth 60% të planit vjetor të programit.

04320	Mbeshtetje per Energjine	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	12,000	6,109	92.3%	93.3%	50.9%
1.1	Personeli	9,000	5,289	69.2%	80.8%	58.8%
1.2	Operative	3,000	820	23.1%	12.5%	27.3%
2	Shpenzime kapitale	1,000	440	7.7%	6.7%	44.0%
2.1	Financim i brendshem	1,000	440	7.7%	6.7%	44.0%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	13,000	6,549	100.0%	100.0%	50.4%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	13,000	6,549	100.0%	100.0%	50.4%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Në këtë program është parashikuar vetëm një produkt buxhetor i lidhur me kuadrin ligjor, i cili raportohet të jetë realizuar pjesërisht, në raport me planin vjetor.

Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore”

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 25 për qind të totalit të shpenzimeve 9-mujore. Sipas zërave kryesore krahasuar me zërat e planin vjetor realizimi paraqitet si më poshtë:

04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	164,647	113,319	67.9%	64.8%	68.8%
1.1	Personeli	132,700	96,317	54.7%	55.1%	72.6%
1.2	Operative	31,947	17,002	13.2%	9.7%	53.2%
2	Shpenzime kapitale	78,000	56,989	32.1%	32.6%	73.1%
2.1	Financim i brendshem	78,000	56,989	32.1%	32.6%	73.1%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	242,647	170,308	100.0%	97.5%	70.2%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	4,436	0.0%	2.5%	
4	TOTALI	242,647	174,744	100.0%	100%	72.0%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore”, përmbledh fondet e miratuara për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, dhe fondet e alokuara nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për këtë program, përbëjnë rreth 17% të fondeve të miratuara për këtë Ministri. Sikurse evidentohet nga tabela e mësipërme, për tremujorin e tretë, shpenzimet për personelin përbëjnë rreth 55% të planit vjetor, dhe shfaqin një nivel realizimi prej rreth 73%. Ndërkohë shpenzimet operative sërish shfaqin një nivel realizimi prej rreth 53%. Shpenzimet kapitale, në këtë program, shfaqin një nivel realizimi më të lartë sa ato të programeve të tjera, me rreth 73%, në raport me planin vjetor. Si konkluzion, ky program rezulton me një nivel realizimi të shpenzimeve buxhetor prej rreth 72%, duke shfaqur kështu një performancë të kënaqshme. Në këtë program janë parashikuar 13 produkte buxhetore, të lidhura me auditime, raportime, vlerësime, studime e të ngjashme, të cilat janë realizuar pjesërisht në raport me planin vjetor.

Programi “Mbështetje për mbikqyrjen e standarteve teknike të hidrokarbureve dhe minierave”

Gjithashtu edhe ky program përmbledh rreth 25% të fondeve të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për vitin 2014, dhe në kompleks, përmbledh fondet e miratuara për funksionimin e Inspektoriatit Qëndror Teknik. Realizimi i shpenzimeve për tremujorin e tretë, krahasuar me planin vjetor jepet nga tabela e mëposhtme.

04440	Mbeshtetje per Mbikqyrjen e Standarteve te Hidrokarbureve dhe Minierave	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	251,102	161,614	72.3%	93.5%	64.4%
1.1	Personeli	157,300	110,285	45.3%	63.8%	70.1%
1.2	Operative	93,802	51,329	27.0%	29.7%	54.7%
2	Shpenzime kapitale	96,400	11,288	27.7%	6.5%	11.7%
2.1	Financim i brendshem	96,400	11,288	27.7%	6.5%	11.7%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	347,502	172,902	100.0%	100.0%	49.8%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	347,502	172,902	100.0%	100.0%	49.8%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse mund të evidentohet edhe nga tabela e mësipërme, programi paraqet një nivel realizimi të shpenzimeve publike prej rreth 50% në total, ndërkohë që shpenzimet korente janë realizuar në masën rreth 64.4% për tremujorin e tretë. Sërish shpenzimet e personelin renditen në nivelin prej 70% të planit vjetor, ndërsa shpenzimet operative sërish në nivele të ulta, prej 50%. Shpenzimet kapitale janë realizuar edhe ato në një nivel të ulët. Investimet këtu përbëjnë rreth 28% të fondeve të planifikuara ndërkohë që realizimi i tyre për periudhën 9-mujore është vetëm 11.7 për qind. Në këtë program janë parashikuar 9 produkte buxhetore, të cilat tregojnë një performancë mjaft të dobët për periudhën 9-mujore, pasi në terma të vlerës së fondeve të alokuara janë realizuar vetëm 11.3 milion lek nga 334.4 milion lek të parashikuara.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË SHPENZIMEVE FAKTIKE

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e shpenzimeve faktike të raportit të hartuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të krahasuara me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit në Ministrinë e Financave.

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	MEI	MF	Dif	MEI	MF	Dif	MEI	MF	Dif
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	230,691	230,691	0	90,172	90,172	0	320,863	320,863	0
Mbeshtetje per Energjine	6,109	6,109	0	440	440	0	6,549	6,549	0
Mbeshtetje per Burimet Natyrore	113,319	113,319	0	56,989	56,989	0	170,308	170,308	0
Mbeshtetje per Mbikqyrjen e Standarteve te Hidrokarbureve dhe Minierave	161,614	161,614	0	11,288	11,288	0	172,902	172,902	0
Totali i Shpenzimeve	511,733	511,733	0	158,889		0	670,622	670,622	0

Burimi: Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet nga tabela me sipër, nuk ka diferenca midis të dhënave faktike të raportuara nga institucioni dhe të dhënave të regjistruara në sistemin e thesarit.

VOLUMI DHE MADHËSIA E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për të katërt programet e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programet	Buxheti fillestar 2014	Buxheti me ndryshime	Diferenca
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	676,990	807,830	130,840
Mbështetje për Energjinë	13,000	13,000	0
Mbështetje për Burimet Natyrore	244,200	242,647	-1,553
Mbështetje për mbikqyrjen e standarteve teknike të hidrokarbureve dhe minierave	308,040	347,502	39,462
Totali i institucionit	1,242,230	1,410,978	168,748

Burimi: Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të dhënat në mijë lek

Ndryshimet në planin e buxhetit, shpjegohen me ndryshimet në fondet e miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, në vijim të përdorimit të fondit të veçantë, sipas miratimeve rast pas rasti nga Ministri i Financave, konform legjislacionit në fuqi dhe në vijim të kërkesave të institucionit, ndryshimeve të fondeve me Aktin Normativ, dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave.

KOMENTE TË TJERA

Në raportin e monitorimit, duhet të përfshihet informacion mbi realizimin e të gjitha produkteve të programeve buxhetore, të cilat gjithashtu duhet të jenë të lidhura edhe me realizimin e objektivave të politikës së programit.

PUBLIKIMI NË FAQEN E INTERNETIT

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit vjetor të buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2014.